

S.T.I.K.P  
~~D.P.K.2.H.T~~  
12.06.2023

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË  
ZYRË E PËRMBARIMIT PRIVAT "QEVA"- SH.P.K



Nr. 518/3 Regj

Pogradec më 26.04.2023

NJOFTIM ME AFISHIM PUBLIK NË GJYKATËN E RRETHIT GJYQËSOR KORÇË DHE BASHKIA  
MALIQ PËR NJOFTIMIN E AKTEVE PËRMBARIMORE

Drejtuar	- Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë Rruga "Nënë Tereza",	<u>Korçë.</u>
Drejtuar	- Bashkia Maliq Rruga Rinia,	<u>Maliq.</u>
Për dijëni Kreditorit:	-Fondi BESA sh.a. Rr "Dritan Hoxha", Laprakë,	<u>Tiranë.</u>

Pranë Shoqërisë Zyrë e Përmbarrimit Privat "QEVA" sh.p.k, me kërkesën e palës kreditore, më datën 13.03.2023, është regjistruar çështja përmbarrimore me numër 518 regjistri, me palë :

**Kreditor :** Fondi BESA sh.a.  
**Debitor :** Gentiana Yllëson Pashollari.  
**Dorëzanës :** Dhurata Adem Pashollari.  
**Me objekt :** Kthim Shume.

Shtetasit Gentiana Yllëson Pashollari, me datëlindje 19.12.1974 dhe dorëzanësi Dhurata Adem Pashollari, me datëlindje 0.11.1949, në cilësinë e palës debitore nga aktet e ndodhura në dosjen përmbarrimore rezulton se, nuk realizohen njoftimet prej shërbimit postar, në adresën e përcaktuar, në Lajmërim për Ekzekutimin Vullnetar të Detyrimit. Ndodhur përpara këtyre rrethanave, duke qënë se njoftimi për palët debitore është i pamundur pasi (në adresën e vënë në dispozicion rezulton të larguar) bazuar në Nenin 517/4 të K.Pr.Civile sipas të cilit "Përmbarruesi gjyqësor kryen ajmërimet dhe njoftimet duke zbatuar parashikimet e pjesës së I, titulli VI, kreu IV, "Njoftimet" dhe nenet 33/a, 133/b, të K.Pr.Civile vendosi të bëjë njoftimin me shpallje për njoftimin e procedurës përmbarrimore për Gentiana Yllëson Pashollari dhe Dhurata Adem Pashollari.

Ky njoftim me shpallje do të jetë 20 ditor. Një kopje e kësaj shpallje të vendoset tabelën e njoftimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, një kopje në tabelën e njoftimeve Bashkinë Maliq, një kopje të publikohet në Eëb-in e Gjykatës dhe një kopje në dosjen përmbarrimore.

Shkëlidhur ju dërgojmë kopje të shkresës Nr.518/1, datë 31.03.2023 "Lajmërim për ekzekutim vullnetar" dhe shkresën Nr.518/2, datë 31.03.2023 "Njoftim për deklarim" për të bërë shpalljen në institucionin Tuaj. Mëkëmbë ju falenderuar për bashkëpunimin,

ZYRË E PËRMBARIMIT PRIVAT "QEVA" SH.P.K  
PËRMBARUESI GJYQËSOR PRIVAT  
Erzen QEVA



Nr. 58 Post



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË  
ZYRË E PËRMBARIMIT PRIVAT "QEVA"- SH.P.K



Nr. 518/1 Regj

Pogradec më 31.03.2023

**LAJMËRIM**  
**"PËR EKZEKUTIM VULLNETAR"**

**Drejtuar Debitorit:** - Gentiana Yllëson Pashollari, me datëlindje 19.12.1974, ID H46219141F.  
Blloku Nr. 3, Qendër Maliq, **Maliq.**

**Dorëzanësit:** - Dhurata Adem Pashollari, me datëlindje 10.11.1949, ID E96110136P.  
Blloku Nr. 3, Qendër Maliq, **Maliq.**

**Për dijjeni Kreditorit:** -Fondi BESA sh.a.  
Rruga "Dritan Hoxha", Laprakë, **Tiranë.**

-Fondi BESA sh.a, Dega Nr.1, Korçë.  
Rruga "Ismail Qemali", **Korçë.**

Në Regjistrin e Titujve Ekzekutivë të Zyrës së Përmbarrimit Privat "QEVA" sh.p.k, me kërkesën e palës kreditore Nr. 23575/10 Prot, të datës 08.03.2023, më datën 13.03.2023, është regjistruar çështja përmbarrimore me numër 518 regjistri, me palë :

**Kreditor :** Fondi BESA sh.a.

**Debitor :** Gentiana Yllëson Pashollari.

**Dorëzanës :** Dhurata Adem Pashollari.

**Me objekt :** Kthim Shume.

Unë përmbarruesi gjyqësor Erzen Qeva, pasi shqyrtova materjalin e plotë të dosjes përmbarrimore :

**KONSTATOVA :**

- Në titullin ekzekutiv, Kontratë Kredie me Nr. 1961 Rep, Nr. 986/1 Kol, të datës 09.11.2017, për të cilën Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka lëshuar "Urdhrin e Ekzekutimit", vendimin me Nr. 742 UE, të datës 16.11.2022, është vendosur detyrimi i debitorit Gentiana Pashollari dhe dorëzanëses Dhurata Pashollari të paguajnë detyrimin në shumën **49,639 (Dyzetë e nëntë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e nëntë) lekë**, në favor të kreditorit "Fondi BESA" sh.a.

-Debitori është i detyruar të paguajë kamat vonesat në bazë të nenit 5, të Ligjit Nr. 48/214 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregëtare" të llogaritura sipas akt- ekspertimit të vlerësuesit Ahmed Guxholli deri më datë 27.03.2023, në shumën **1,946 (Një mijë e nëntëqind e dyzetë e gjashtë) lekë**, në favor të kreditorit Fondi BESA sh.a, si dhe kamatat ligjore ditore pas kësaj date në vlerën **14 (Katërmëdhjetë) lekë** në ditë, deri në ekzekutimin e plotë të detyrimit.

-Debitori është i detyruar të paguajë shpenzimet e ekspertit në shumën **9,000 (Nëntë mijë) lekë** sipas faturës elektronike të shitjes me nr. 19/2023, datë 30.03.2023.

-Debitori është i detyruar të paguajë tarifën e shërbimit përmbarimor sipas Udhëzimit me Nr. 385/7, të datës 28.06.2017, “Për caktimin e tarifave dhe shërbimet e ofruara nga shërbimi përmbarimor gjyqësor privat” i ndryshuar me Udhëzimin nr. 30, datë 30.08.2018, në shumën **13,200 (Trembëdhjetë mijë e dyqind) lekë**, me TVSH, si dhe çdo shpenzim tjetër të lindur gjatë ekzekutimit të urdhrit të ekzekutimit sipas nenit 525 të K.Pr. Civile.

**Në total detyroheni të paguani shumën 73,785 (Shtatëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e pesë ) lekë.**

Pala kreditore ka kërkuar pranë nesh ekzekutimin e titullit dhe në zbatim të ligjit është i detyrueshëm njoftimi juaj si palë debitore për ekzekutimin e titullit në mënyrë vullnetare.

Për këtë arsye : Në bazë të nenit 517 e 518 të K.Pr.Civile .

### **K Ë R K O J M Ë :**

Kryerjen e ekzekutimit vullnetar të “Urdhrit të Ekzekutimit”, vendimit me Nr. 742 UE, të datës 16.11.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, si më poshtë;

-Debitori Gentiana Pashollari dhe dorëzanësja Dhurata Pashollari të paguajnë detyrimin në shumën 73,785 (Shtatëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e pesë ) lekë, në mënyrë vullnetare brënda 10 (dhjetë) ditësh, duke filluar ky afat nga dita e marrjes dijani.

- Debitorët që refuzojnë ose nuk kryejnë sipas asaj që ka vendosur vendimi i gjykatës do të gjobitet deri në 50.000 (Pesëdhjetë mijë) lekë, deri në ekzekutimin e detyrimit , si dhe kallëzim për ndjekje penale, për pengim ekzekutimi në bazë të nenit 320 të Kodit Penal.


- Derdhja e shumës së mësipërme të kryhet detyrimisht pranë Raiffeisen Bank, në llogarinë e veçantë me Nr. Llog. 0041367009 , IBAN AL79 2024 2004 0000 0000 41367009 SGSBALTX, të Shoqërisë Zyrë e Përmbarimit Privat “QEVA” Sh.p.k.

- Bashkëngjitur lajmërimit po j’u përcjellim Aktin e Ekspertimit të datës 29.03.2023 të përgatitur nga Eksperti “Kontabël i Miratuar” Z. Ahmed Guxholli dhe Fatura tatimore, lidhje \_\_\_\_\_ faqe.

**ZYRË E PËRMBARIMIT PRIVAT “QEVA” SH.P.K**

**PËRMBARUESI GJYQËSOR PRIVAT**

**Erzen Z QEVA**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË  
ZYRË E PËRMBARIMIT PRIVAT "QEVA"- SH.P.K



Nr. 518/2 Regj

Pogradec më 31.03.2023

**NJOFTIM PËR DEKLARIM**

**Drejtuar Debitorit:** - Gentiana Yllëson Pashollari, me datëlindje 19.12.1974, ID H46219141F.  
Blloku Nr. 3, Qendër Maliq ,

Maliq.

**Dorëzanësit:** - Dhurata Adem Pashollari, me datëlindje 10.11.1949, ID E96110136P.  
Blloku Nr. 3, Qendër Maliq ,

Maliq.

**Për dijëni Kreditorit:** -Fondi BESA sh.a.  
Rruga "Dritan Hoxha", Laprakë,

Tiranë.

-Fondi BESA sh.a, Dega Nr.1, Korçë.  
Rruga "Ismail Qemali",

Korçë.

Në Regjistrin e Titujve Ekzekutivë të Zyrës së Përmbarimit Privat "QEVA" sh.p.k, me kërkesën e palës kreditore Nr. 23575/10 Prot, të datës 08.03.2023, më datën 13.03.2023, është regjistruar çështja përmbarimore me numër 518 regjistri, me palë :

**Kreditor :** Fondi BESA sh.a.

**Debitor :** Gentiana Yllëson Pashollari.

**Dorëzanës :** Dhurata Adem Pashollari.

**Me objekt :** Kthim Shume.

Unë përmbaruesi gjyqësor Erzen Qeva, pasi shqyrtova materjalin e plotë të dosjes përmbarimore :

Për vënien në ekzekutim të Titullit Ekzekutiv, Kontratë Kredie Nr. 1961 Rep, Nr. 986/1 Kol, të datës 09.11.2017, për të cilën Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka lëshuar "Urdhrin e Ekzekutimit", vendimin me Nr. 742 UE, të datës 16.11.2020,

**Jeni lajmëruar se;**

Duhet të përmbushni vullnetarisht detyrimin, duke paguar në llogarinë e veçantë të Shoqërisë Zyrë e Përmbarimit Privat "QEVA" sh.p.k, pranë Raiffeisen Bank, me Nr.Llog. 0041367009 , IBAN AL79 2024 2004 0000 0000 41367009 SGSBALTX, Brenda 10 (Dhjetë) ditësh, shumën 73,785 (Shtatëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e pesë ) lekë, shumë e cila përbën detyrimin kundrejt palës kreditore, shpenzimet dhe tarifën e shërbimit përmbarimor deri në këtë moment. Në rast të mospërmbushjes së detyrimit, në mënyrë vullnetare kjo shumë do të përlllogaritet dhe rritet, për shkak të interesave ligjore ditore, sipas parashikimeve të Titullit Ekzekutiv dhe legjislacionit në fuqi,

kjo në bazë të nenit 5 të Ligjit Nr.48/214 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregëtare” deri në ekzekutim të plotë të detyrimit, dhe në bazë të nenit 525 të K.Pr.Civile do të shtohen edhe shpenzimet gjatë ekzekutimit.

**Referuar Ligjit Nr. 26/2019, datë 08.05.2019 “Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat” dhe nenit 517 (paragrafi i 2-të) të K.Pr.Civile ku citohet se ;**  
**“Me marrjen e lajmërimit për ekzekutim vullnetar, debitori është i detyruar të deklarojë me shkrim gjendjen pasurore, si dhe sendet ose kredi që personat të tretë i detyrohen”**

### **JU KËRKOJMË TË DEKLAROHENI;**

Në lidhje me këtë kërkesë të ligjit, duke u paraqitur pranë ambjenteve të Shoqërisë Zyrë e Përmbarimit Privat “QEVA”sh.p.k, lagjja Nr.3, Rr “Andon Xoxe, Pogradec, për të përmbushur këtë veprim procedural përmbarimor, apo duke dërguar në adresën zyrtare të Shoqërisë Zyrë e Përmbarimit Privat “QEVA” sh.p.k, ( [shoqeriaqeva@gmail.com](mailto:shoqeriaqeva@gmail.com) ) deklarim në formë të shkruar Brenda afatit 10-ditor të parashikuar nga ligji për ekzekutimin vullnetar të detyrimit nga ana juaj.

Në lidhje me këtë kërkesë ligjore,

**Ju njoftojmë** se ky deklarim me shkrim kërkohet të kryhet përpara se të fillojë procesi i sekuestrimit të kredive apo të sendeve për të cilat përmbaruesi gjyqësor duhet të sigurohet nëse ju përkasin juve apo personave të tretë të cilët mund të kenë një detyrim ndaj jush.

**Ju njoftojmë** gjithashtu se nëpërmjet konfirmimit të deklarimit tuaj të detyruar me shkrim, ju nuk duhet të jepni një deklarim të rremë, i cili në kuptim të nenit 581 të K.Pr.Civile dhe në zbatim të nenit 320 të K.Penal të Republikës së Shqipërisë, mund t’ju bëjë subjekt të një procesi penal në Prokurorinë e Shtetit.

**ZYRË E PËRMBARIMIT PRIVAT “QEVA” SH.P.K**

**PËRMBARUESI GJYQËSOR PRIVAT  
Erzen Z QEVA**

